Kronikë

# Në gjendje të dehur, nxori armën pas një konflikti çasti, arrestohet polici Aldo Braholli në Korçë

*Aldo Braholli, punonjës policie në Pikën e Kalimit Kufitar Goricë është arrestuar nga Drejtoria Rajonale e AMP Korçë  pasi nxori armën pas një konflikti çasti kur ishte jashtë shërbimit dhe tentoi të qëllonte një person.*



*Foto ilustruese*

Redaksia
30 Prill, 11:43 | Përditesimi i fundit: 30 Prill, 12:29

Aldo Braholli, punonjës policie në Pikën e Kalimit Kufitar Goricë është arrestuar nga Drejtoria Rajonale e AMP Korçë  pasi nxori armën pas një konflikti çasti kur ishte jashtë shërbimit dhe tentoi të qëllonte një person. Ngjarja ka ndodhur më 28 prill 2022 kur ishte jashtë detyrës funksionale, u përfshi në konflikt për motive të dobëta me shtetasin B.D.

Nga veprimet e para hetimore ka rezultuar se në momentin që punonjësi i policisë i ka drejtuar armën e shërbimit shtetasit B. D., ky i fundit ka mundur ta ndalojë duke i marrë armën nga dora, të cilën më pas e ka dorëzuar pranë shërbimeve të policisë.



LEXO EDHE:
**Operacioni anti-drogë në Korçë, shkon në 25 numri i të ndaluarve! 6 në kërkim 70 të tjerë në hetim penal**

Ndaj punonjësit të policisë janë referuar materialet hetimore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë për veprën penale "Vrasje me dashje" mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76 dhe 22 të Kodit  Penal.

Hetimet vijojnë për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarje.

A.M./Shqiptarja.com

TAG: Pika e Kalimit Kufitar Goricë | tentative vrasje | Aldo Braholli | Korce

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**A mendoni se autobusi në Lanë duhet të kthehet në instalacion?**

Po | Jo | Nuk e di




RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

## Lajme të tjera

Kronikë

Plagosja e Johan Muçllarit në Pogradec, lihen në burg për përkrahje të autorëve 5 personat e arrestuar
29 Prill, 18:22

Kronikë

Kapet me 2 kg drogë 56-vjeçari në Kapshticë, tentoi të korruptojë policin me 600 euro
28 Prill, 21:20

Kronikë

Endri Prifti denoncoi ish-gruan në emisionin investigativ, Prokuroria e Korçës i sekuestron shtëpinë
27 Prill, 21:51

Kronikë

U kapën me 16 emigrantë të paligjshëm në dy automjete, arrestohen 3 persona në Korçë, njëri shqiptar i Kosovës (Emrat)
26 Prill, 10:26

Politikë

Demokrati u paraqit në zgjedhjet e 'Rithemelimit' në Korçë me autorizimin e Azem Hajdarit, emocionohet e bija: PD do t'i rikthehet idealeve
26 Prill, 09:20

Kronikë

Fluks automjetesh prej disa ditësh në Kapshticë, emigrantët shqiptar kthehen në tokën greke pas javës së Pashkëve
26 Prill, 08:38

Kronikë

Atentat për herë të tretë djalit të pronarit të hotel 'Volorekës', në kërkim i biri i 'të fortit' të Pogradecit së bashkë me mikun e tij! Historiku i konfliktit disavjeçar
25 Prill, 16:31

Politikë

Përfundojnë zgjedhjet për kryetar dege në Maliq, fitues shpallet Nevjon Kodrasi
24 Prill, 18:54

Kronikë

Makina përplas këmbësorin në Maliq, ndërron jetë në spital, shoqërohet drejtuesi i mjetit
24 Prill, 12:03

Kronikë

'Bonzai' droga që kërcënon të rinjtë, në Shqipëri u fut me postë nga Greqia, priten analizat! Operacioni në Korçë që zbuloi rrjetin me 100 trafikantë
 Arsen Rusta
24 Prill, 10:55

Kronikë

U përplas nga një makinë në rrugën Korçë-Devoll, humb jetën këmbësori 50-vjeçar(VIDEO)
23 Prill, 21:13

Kronikë

U arrestuan për shpërndarje droge në Korçë 2 ditë më parë, lihen në burg 17 nga 24 të arrestuarit
22 Prill, 16:14



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje